

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**, Departamenti për Krime të Rënda, si penale, gjyqtari njëherit edhe kryetar i trupit gjykues, Xheladin Osmani, me procesmbajtsets Fatmire Kastrati – sekretare juridike e kësaj gjykate, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit I. G., për shkak të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KP-së, sipas aktakuzës së PSH-së në Prizren, PP.nr.16/2017 e dt.04.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datën 19.04.2017, në prezencën e përfaqësuesit të akuzës- prokurorit të shtetit Ervehe Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, av. E. G., po të njëjtën ditë muar dhe publikisht shpalli këtë

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

**I. G.**, nga i ati M. dhe e ëma B., me mbiemër të vajzërisë M., i lindur më dt. ..., në Prizren, me banim të përhershëm në fshatin ..., Komuna e Prizrenit, shqipëtar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, moler, i martuar, baba i një fëmiju, i gjendjes së varfër ekonomike.

**ËSHTË FAJTOR**

Më datë 31 Janar 2017, rreth orës 20:11 minuta , në fshatin ..., gjatë bastisjes dhe kontrollimit të shtëpisë, objekteve përcjellse të pandehurit Idriz Gavazaj, policia ka gjetur një kuti pllastike në të cilën ishte një substancë e dyshuar për narkotik të llojit marihuanë, me një peshë prej 44.06 gram, një paketim i mbeshtjellur me qese plastike në të cilën ishte një substancë e dyshuar për narkotik të llojit marihuanë në peshë prej 972.1 gram, një paketim e mbeshtjellur në qese plastike në të cilën ishte një substancë e dyshuar për narkotik të llojit marihuanë në peshë rreth 1011.4 gram së bashku me disa qese plastike të cilat shërbejnë për paketimin gjatë shitjes së substancave narkotike të llojit marihuanë, e të cilat i pandehuri I. G. pa autorizim i ka poseduar me qëllim të shitjes dhe shpërndarjes, e të cilat i ka bler nga dy persona nga Kukësi dhe për të njejten pos transportit ka paguar edhe 400 (katerqindë) euro.

Me këtë ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 273 par.1 të KP.

Gjykata në kuptim të nenit 7,8,9,10,17,41,42,43,45,46,73,74,75 par.1 p.3,76 si dhe neni 273 par.1 të KP-së, të akuzuarin Idriz Gavazaj, e

**G J Y K O N**

Me dënim me gjobë në shumen prej 1000 (njëmijë) euro dhe me dënim burgu në kohëzgjatje prej 18 (tetëmbdhjetë) muajve, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 31.01.2017 gjërë më datën 19.04.2017.

I akuzuari dënimi me gjobë duhet ta paguaj në katër këste duke filluar në fillim të çdo kësti vijues, e nëse i akuzuari nuk mundë apo nuk dëshiron ta paguaj, gjykata do të ia zavendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg, ashtu që çdo 20 euro të dënimit me gjobë do të caktojë një ditë burgu, gjëgjësishtë me 50 ditë burg.

Në bazë të nenit 273 par.5 KP prej të akuzuarit konfiskohet sasia e narkotikut – marihuanës : një kuti plastike në të cilën ishte një substancë e dyshuar për narkotik, të llojit marihuan, me një pesh prej 44,6 gram, një paketim i mbeshjtellur me qese plastike në të cilën ishte një substancë e dyshuar për narkotik të llojit marihuan, në peshen prej 972.1 gram, një paketim i mbeshjtellur me qese plastike në të cilën ishte substancë e dyshuar për narkotik të llojit marihuanë me një peshë prej 1011.4 gram, disa qese pllastike të cilat sherbejnë për paketimin gjatë shitjes së substancave narkotike të llojit marihuanë, disa rrizlla –mbeshjtellse për marihuanë. me peshë prej 1040 (njëmijekaterdhjet ) gram, si objekt i kryerjes së veprës penale.

Obligohet i akuzuarit që ta paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 (pesdhjetë) Euro në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria e Shtetit – Departamenti për krime të rënda në Prizren, ka ngritur aktakuzën PP.nr.16/2017 të datës 04.04.2017, kundër të akuzuarit I. G. nga fshati ..., Komuna e Prizrenit, për shkak të veprës penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KP, të cilën aktakuzë gjatë seancës fillestare e ka përfaqësuar Prokurori i shtetit Ervehe Gashi.

Aktakuzen në fjalë në shqyrtimin fillestar ka lexuar prokurori i shtetit Ervehe Gashi e cila qëndroi në tërësi pranë të dhënave si në aktakuzë, dhe propozojë që të fillohet me seancën fillestare dhe në fazat tjera të seancave gjyqësore.

Në seancën fillestare, i akuzuari u udhëzua në kuptim të nenit 246 të KPP për të drejtat e tij dhe pasi që të drejtat e tij janë respektuar, pas leximit të aktakuzës, i akuzuari ka kuptuar aktakuzën i është ofruar mundësia e tij të pranojë fajësinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe se e pranon fajësinë për veprën penale shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273 par.1 të KP.

Kryetari i trupit gjykues vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit dhe se pranimi është bërë vullnetarisht, pastaj pranimi është mbështetur në faktet e çeshtjës që përmban aktakuza, nga materialet e prezentuara nga prokurori i shtetit dhe provat tjera dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qart ligjore ose gabime faktike, i akuzuari e pranoi fajsinë në të gjitha pikat e aktakuzës dhe atë pas marrjes së mendimit të prokurorit, mori vendimin mbi pranimin e fajsisë e pastaj është vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Me vet pranimin nga ana e të akuzuarit dhe nga shkresat e lëndës, është vërtetuar në tërësi pretendimi i Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti për krime të rënda të përshkruara si në dispozitivin e aktakuzës dhe është vërtetuar se i akuzuari është përgjegjës penalo-juridike për veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotropike dhe analoge, nga neni 273 par.1 të KP.

Gjykata, nga provat të bashkangjitur në shkresat e lëndës, mbi të cilat është bazuar dhe ngritur aktakuza e PTH-it në Prizren, e poashtu edhe nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit për veprën penale që i vëhet në barrë, duke i analizuar secilën veç e veç dhe duke i ndërlidhur të gjitha së bashku më pa dyshim është ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit, formohen dhe fitohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se i akuzuari në aspektin penalo- juridik është përgjegjës për çka gjykata të njëjtin e shpalli fajtor, dhe ia shqiptoj dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 dhe nenit 75 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke gjetur si rrethanë rënduese, rrezikun shoqëror, shkallen e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, e sidomos sasia e narkotikut, ndërsa si rrethanë posaqërisht lehtësuese është marrë qëndrimi korrekt dhe pranimi i fajësisë, pendimin dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepër të re penale.

Vendimi mbi konfiskimin u muar në kuptim të nenit 273 par.5 dhe neni 69 par.1 të KP.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 par.2 pika 6 të KPP.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti për Krime të Rënda**  
**PKR.nr.36/2017, dt.19.04.2017**

**Sekretarja Juridike**  
 Fatmire Kastrati

**Kryetari i trupit gjykues**  
 Xheladin Osmani